



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-05

Prokuroria kundër Salih Mustafës

Vendosi: **Trupi Gjykses I**

Gjykatëse Mapi Veld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhiliber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, Gjykatës Rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 15 korrik 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim që hedh poshtë Mocionin Paraprak të Mbrojtjes së Salih Mustafës që
Kundërshton Juridiksionin e DHSK-së**

Për t'iu njoftuar:

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të të Akuzuarit
Julius von Bone

Mbrojtëses së Viktimave
Ani Pues

TRUPI GJYKUES I ("Trupi Gjykues"), nxjerr këtë vendim, që hedh poshtë Mocionin Paraprak të Mbrojtjes së Salih Mustafës që Kundërshton Juridiksionin e DHSK-së" ("Mocioni i Mbrojtjes").¹

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 28 shtator 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbajti seancën e paraqitjes së parë të Salih Mustafës ("z. Mustafa "ose "i akuzuari"), në të cilën, ndër të tjera, i akuzuari u informua për të drejtat e tija, përfshirë të drejtën për të paraqitur mocione paraprake.²

2. Më 23 tetor 2020, me urdhër të Gjykatësit të Procedurës Paraprake,³ Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") përfundoi nxjerrjen e informacionit për Mbrojtjen sipas rregullës 102(1) të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), duke nisur kështu afatin 30-ditor për Mbrojtjen që të paraqiste mocionet paraprake sipas rregullës 97(1)(a) deri (c) të Rregullores.⁴

3. Më 7 maj 2021, në mungesë të paraqitjes së mocioneve paraprake të rregullës 97 nga Mbrojtja dhe pasi ishin ndërmarrë të gjitha hapat procedurale, në pajtim

¹KSC-BC-2020-05, F00149, Mbrojtja, *Mocion Paraprak i Mbrojtjes së Salih Mustafës që Kundërshton Juridiksionin e DHSK-së*, 7 korrik 2021, publik.

² KSC-BC-2020-05, Transkripti i seancës, 28 shtator 2020 (Transkripti i seancës 28 shtator 2020), publik, f. 9, rreshtat 12-14.

³ KSC-BC-2020-05, F00034, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje lidhur me Të* (Vendimi Kornizë), 9 tetor 2020, publik, para. 90(b).

⁴ *Shih* paketat e nxjerrjes së informacionit 5, 6, 8 dhe 28. *Shih gjithashtu*, KSC-BC-2020-05, F00119/A02, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Dokumenti Dorëzues* (Dokumenti Dorëzues), 7 maj 2021, konfidencial, f. 18.

me rregullën 98(1), Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia kaloi dosjen e çështjes gjyqësore Trupit Gjykues.⁵

4. Më 7 korrik 2021, Mbrojtja paraqiti Mocionin e Mbrojtjes.

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

5. Trupi Gjykues vë në dukje nenet 33(1)(b), 39(1), 40(1) dhe 45(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji) dhe rregullat 9(5), 97, 98(1) dhe 102(1)(a) të Rregullores.

III. ANALIZA

6. Trupi Gjykues nënvizon se dispozitat ligjore përkatëse përpara Dhomave të Specializuara (DHS) tregojnë qartë se kur mund të paraqiten mocione paraprake, përfshirë ato që kundërshtojnë juridiksionin e DHS-së. Sipas rregullës 97(2) të Rregullores, një mocion paraprak që kundërshton juridiksionin e DHS-së, sikurse dhe Mocioni i Mbrojtjes, paraqitet brenda tridhjetë (30) ditësh nga nxjerrja e të gjitha materialeve dhe deklaratave të përmendura në rregullën 102(1)(a) të Rregullores. Rregulla 102(1)(a) e Rregullores përcakton se kjo nxjerrje, që ka të bëjë me materialet mbështetëse për aktakuzën e dorëzuar për konfirmim si dhe me të gjitha deklaratat e marra nga i akuzuari, duhet bërë brenda tridhjetë (30) ditësh pas paraqitjes së parë të të akuzuarit në zbatim të rregullës 92 të Rregullores. Duke pasur parasysh se paraqitja e parë e z. Mustafa u bë më 28 shtator 2020⁶ dhe se nxjerrja e materialit të rregullës 97(1)(a) nga ZPS-ja për Mbrojtjen u përfundua më 23 tetor 2020,⁷ afati që Mbrojtja të

⁵ KSC-BC-2020-05, F00119, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi për Kalimin e Dosjes së Çështjes Gjyqësore Trupit Gjykues I*, 7 maj 2021, publike, dhe Shtojca 1, rreptësisht konfidenciale dhe Shtojca 2, konfidenciale.

⁶ Transkripti i seancës 28 shtator 2020.

⁷ Dokumenti Dorëzues, f. 18.

paraqiste çdo mocion paraprak sipas rregullës 97(1)(a) deri (c) të Rregullores ishte të martën, 24 nëntor 2020.

7. Për më tepër, Trupi Gjykses thekson se dispozitat ligjore të DHS-së përcaktojnë se sipas nenit 39(1) të Ligjit , është detyrë e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, që të trajtojë në mënyrë shteruese çdo mocion paraprak të rregullës 97 të Rregullores, përpara se t'ia kalojë dosjen e çështjes Trupit Gjykses. Për më tepër, në lidhje me mocionet paraprake që kundërshtojnë juridiksionin e DHS-së (rregulla 97(1)(a)), në zbatim të nenit 45(2) të Ligjit dhe rregullës 97(3) të Rregullores, secila prej palëve ka të drejtën të apelojë drejtpërsëdrejti vendimin(et) e Gjykatësit të Procedurës Paraprake për këto kundërshtime juridiksionale. Është me rëndësi të përmendet se Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund t'i përcjellë dosjen e çështjes Trupit Gjykses sipas rregullës 98(10) të Rregullores, vetëm pasi të jetë marrë çdo vendim përfundimtar mbi mocionet paraprake, nëse janë paraqitur. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses tërheq vëmendjen lidhur me leximet e kombinuara të neneve 33(1)(b) dhe 40(1) të Ligjit, që përcaktojnë se Kryetari i DHS-së do të caktojë një trup gjykses menjëherë pasi të jenë marrë vendimet për çdo mocion paraprak, përfshirë kundërshtimet për formën e aktakuzës dhe juridiksionin dhe pasi Gjykatësi i Procedurës Paraprake të ketë vlerësuar se çështja është gati për gjykim.

8. Nga kjo rrjedh se çdo mocion paraprak sipas rregullës 97 të Rregullores duke përfshirë këtu për këtë arsye edhe Mocionin e Mbrojtjes, në parim paraqitet gjatë fazës së procedurës paraprake, para Gjykatësit të Procedurës Paraprake, që ka juridiksionin mbi këto kundërshtime. Për më tepër, në lidhje me mocionet paraprake që kundërshtojnë juridiksionin e DHS-së, Ligji dhe Rregullorja përcaktojnë një kuadër ligjor ku problemet që kanë të bëjnë me juridiksionin e DHS-së duhet të zgjidhen në parim, përfshirë në nivelin e apelit, përpara se çështja t'i përcillet Trupit Gjykses, për të siguruar që çështja të përgatitet siç duhet për gjykim dhe këto probleme të mos dalin gjatë fazës së gjykimit.

9. Edhe nëse supozohet se në rrethana të jashtëzakonshme mund të parashikohet një shmangie e sistemit sipas nenit 40(6)(a) të ligjit, Trupi Gjykses vëren se në çështjen aktuale, Mbrojtja nuk ka paraqitur asnjë argument që të justifikojë një vonesë prej pothuaj tetë muajsh për të paraqitur Mocionin e Mbrojtjes, e as nuk ka formuluar asnjë kërkesë për të ndryshuar afatin përkatës sipas rregullës 9(5) të Rregullores. Në këtë aspekt, Trupi Gjykses po ashtu kujton se gjatë paraqitjes së parë të së akuzuarit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e informoi z. Mustafa se ai kishte të drejtën që të paraqiste mocione paraprake për të kundërshtuar juridiksionin e DHS-së dhe të apelonte drejtpërdrejt çdo vendim të tillë të lëshuar për këto mocione.⁸ Në të njëjtin rast, mbrojtësi i z. Mustafa tha se ai nuk e kishte përjashtuar mundësinë se mund të paraqiste kundërshtime të tilla.⁹ Për më tepër, në konferencën për ecurinë e çështjes, më 14 dhjetor 2020 (që do të thotë pas përfundimit të afatit të rregullës 97(2) të Rregullores), Gjykatësi i Procedurës Paraprake vuri re se Mbrojtja nuk kishte paraqitur asnjë mocion paraprak brenda afatit të përcaktuar në rregullën 97(2) të Rregullores dhe mbrojtësi nuk reagoi për këtë.¹⁰

10. Duke pasur parasysh çka më sipër, Trupi Gjykses vendosi që ta hedhë poshtë Mocionin e Mbrojtjes për arsye procedurale, pa shkuar në themelësi, pasi është paraqitur pas afatit të rregullës 97(2) të Rregullores, pa asnjë justifikim përse Trupi Gjykses duhet të shmanget nga dispozitat ligjore përkatëse para DHS-së.

11. Po ashtu, Trupi Gjykses e konsideron të përshtatshme që të theksojë se, në bazë të nenit 6(d) dhe (h) të Kodit të Etikës Profesionale për Mbrojtësit dhe Prokurorët para Dhomave të Specializuara të Kosovës (Kodi i Etikës),¹¹ mbrojtësit e të akuzuarve që ushtrojnë profesionin para DHS-së duhet të veprojnë në pajtim me standardet

⁸ Transkripti i seancës 28 shtator 2020, f. 9, rreshtat 12-14, f. 10, rreshtat 10-12.

⁹ Transkripti i seancës 28 shtator 2020, f. 12, rreshtat 14-16.

¹⁰ KSC-BC-2020-05, Transkripti i seancës, 14 dhjetor 2020, publik, f. 89, rreshtat 10-11.

¹¹ Kodi i Etikës Profesionale për Mbrojtësit dhe Prokurorët para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-07, 1 mars 2019.

profesionale bazë, përfshirë, me sa ka të bëjë: (i) të veprojnë brenda kornizës ligjore së DHS-së dhe në përputhje me të, dhe (ii) të ndërmarrin të gjitha hapat e arsyeshëm për përmbushjen e detyrimeve të tyre nëpërmjet zotërimit të njohurive dhe kompetencës profesionale të nevojshme në të drejtën materiale dhe procedurale të zbatueshme para DHS-së. Për më tepër, sipas nenit 10(b) të Kodit të Etikës, mbrojtësit e të akuzuarve veprojnë në kohë dhe në mënyrë efikase.

12. Trupi Gjykses i kujton mbrojtësit të z. Mustafa dhe ekipit të tij që të zbatojnë standardet profesionale të përcaktuara në Kodin e Etikës.

IV. VENDIM

13. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

HEDH POSHTË Mocionin e Mbrojtjes.

/nënshkrim/

Gjykatëse Mapi Feld-Folia
Kryegjykatëse

/nënshkrim/

Gjykatës Zhilber Biti

/nënshkrim/

Gjykatës Roland Dekers

E enjte, 15 korrik 2021
Hagë, Holandë.